

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK



BASHKIA TIRANË

SISTEMI MULTIFUNKSIONAL PËR SALLËN E KËSHILLIT BASHKIAK

Tiranë, 2026

PËRMBAJTJA

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK.....	1
PËRMBAJTJA.....	2
1. HYRJE.....	3
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues.....	3
1.2. Historiku.....	3
1.3. Situata aktuale	4
1.2.1 Organizimi i Sallës	4
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	5
2.1. Objektivi i Përgjithshëm.....	6
2.2. Qëllimi	6
2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori.....	6
3. SUPOZIMET DHE RISQET	7
3.1 Supozimet	7
3.2 Risqet	7
4. QËLLIMI I PUNËS	7
4.1. Të Përgjithshme.....	7
4.1.1. Përshkrimi i detyrës	7
4.2 Detyrat specifike.....	8
Faza I –Faza përgatitore/analiza e kërkesave.....	8
Faza II – Instalimi/ konfigurimi i sistemit të sallës së këshillit dhe testimi.....	8
Faza III –Trajnimi i përdoruesve.....	9
Faza IV- Marrja në dorëzim.....	9
Faza V – Mirëmbajtje e sistemit	9
5. LOGJISTIKA DHE KOHA.....	10
5.1. Vendndodhja	10
5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave.....	10
6. RAPORTIMI.....	10
6.1. Kërkesat e Raportimin	10
7. GARANCIA.....	11
8. MIRËMBAJTJA	11
9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT	16

10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTI	16
11. SPECIFIKIME TEKNIKE	17
12. PLANIMETRIA.....	17

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Tiranë

1.2. Historiku

Salla e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë është një ambient mbledhjesh ku zhvillohen seancat e këshilltarëve dhe aktivitetet institucionale. Organizimi i sallës është i strukturuar për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet këshilltarëve dhe drejtimit të mbledhjes. E ndërtuar prej vitesh salla aktuale nuk disponon elemente të modernizimit. Aktualisht mbledhjet që organizohen në sallën e Këshillit Bashkiak realizohen me mikrofonë individualë me kablo, modele të vjetra, të tipit analog, pa ekran digjital, pa butona për votim dhe pa sistem identifikimi elektronik.

Infrastrukturat teknologjike aktuale janë të kufizuara: mikrofonat janë të vjetër, të amortizuar, shpesh me zë të paqartë, të dëmtuar fizikisht ose me defekte teknike, duke e vështirësuar komunikimin gjatë seancave. Për shkak të amortizimit, kohës së gjatë të përdorimit, teknologjisë së vjetër, herë pas here mikrofonat kanë shfaqur probleme në funksionimin e tij.

Sisteme të avancuara audio–video, platforma digjitale për votim elektronik, ekrane informuese apo pajisje interaktive mungojnë plotësisht, duke reflektuar një sallë që nuk i përshtatet standardeve bashkëkohore të administrimit publik.

Akustika gjithashtu nuk është e përmirësuar për mbledhje të gjata. Organizimi teknik mbështetet ende në procedura manuale dhe pajisje tradicionale, çka krijon vonesa dhe ul efikasitetin e punës së këshillit.

Ndodhur në këto kushte lind nevoja për digjitalizimin e sallës së këshillit bashkiak të Bashkisë Tiranë dhe për investime teknologjike bashkëkohore.

1.3. Situata aktuale

1.2.1 Organizimi i Sallës

[TAVOLINA E KRYESISË]


(Chairman Unit)

QENDRA

SEKTORI MAJTAS

SEKTORI QENDROR

SEKTORI DJATHTAS



○ = njësi delegate me mikrofon

Struktura e sallës ekzistuese është “**amfiteatër**” **gjysmë-rrethor me 3 sektorë kryesorë**, ku janë vendosur 61 vende për këshilltarët dhe një vend për kryetarin e këshillit.

- **Sektorët e tavolinave**

Rreshtat janë të ndarë në:

Spektori majtas- rreshta gjysmë-rrethorë në anën e majtë të sallës.

Spektori qendror- rreshti kryesor përballë tavolinës së kryesisë.

Spektori djathtas- rreshta gjysmë-rrethorë në anën e djathtë.

Këta sektorë ndahen nga **dy korridore vertikale** që përdoren për lëvizjen e stafit.

- **Salla ka 3 nivele tavolinash:**

Niveli	Përshkrimi
Niveli 1	tavolina më afër kryesisë
Niveli 2	rreshti i dytë
Niveli 3	rreshti i tretë

Totali i vendeve për këshilltarët: 61.

- **Tavolina e kryesisë**

Në pjesën e përparme ndodhet:

- tavolina e kryetarit:
- tavolina e administratës. 2

Këtu vendoset:

- njësia chairman
- mikrofonët e kryesisë.

Salla e Këshillit Bashkiak ka dimensione fizike orientuese si më poshtë:

- Gjatësia e sallës: rreth 15.35 metra
- Gjerësia maksimale (nga tavolina e kryesisë drejt pjesës fundore të sallës): rreth 12.2 metra
- Lartësia maksimale e tavanit: rreth 5 metra

Këto dimensione duhet të merren në konsideratë nga operatori ekonomik për projektimin, vendosjen dhe konfigurimin optimal të sistemit audio-video dhe pajisjeve përkatëse.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Në funksion të ngritjes së një infrastrukture me parametra bashkëkohorë të sallës së Këshillit Bashkiak në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet furnizimi dhe instalimi i komponentëve si më poshtë:

- Sistem diskutimi (njësi delegate/chairman dhe procesor qendror)
- Softuer administrimi dhe votimi
- Kamera PTZ dhe sistem auto-tracking
- Njësi regjistrimi
- Sistem audio i sallës (altoparlantë, amplifikatorë, DSP, mikser)
- Monitor
- Mirëmbajtje të pajisjeve/sistemeve për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim.

2.2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate është ngritja e një infrastrukture me parametra bashkëkohorë të sallës së Këshillit Bashkiak në Bashkinë Tiranë e cila përfshin (por nuk kufizohet) furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe vënia në punë e një sistemi të plotë i cili përfshin sistem diskutimi, identifikim elektronik, votim, sistem audio, regjistrim audio-video, kamera PTZ dhe pajisje mbështetëse, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e institucionit.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

- Furnizim dhe konfigurim për Sistemin e diskutimit (njësi delegate/chairman dhe procesor/njësinë qendrore) sipas kërkesave të këtij dokumenti
- Konfigurim të Lexues/Shkrues kartash, monitor
- Furnizim dhe konfigurim të kartave elektronike të identifikimit
- Furnizim dhe konfigurim Softuer administrimi dhe votimi
- Furnizim dhe konfigurim të Kamera PTZ dhe sistem auto-tracking
- Furnizim dhe konfigurim për Njësi regjistrimi
- Sistem audio i sallës (altoparlantë, amplifikatorë, DSP, mikser)
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe instalojë të gjithë kabllimin e nevojshëm për funksionimin e sistemit.
- Operatori ekonomik duhet të ofrojë një zgjidhje të integruar, ku të gjithë komponentët e sistemit (sistemi i diskutimit, sistemi audio, kamerat PTZ, regjistrimi dhe softueri i menaxhimit) të funksionojnë në mënyrë të koordinuar dhe të jenë plotësisht të integrueshëm ndërmjet tyre.
- Operatori ekonomik, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë duhet të mundësojë trajnimin e punonjësve (stafin teknik) në lidhje me përdorimin e sistemit dhe komponentëve objekt kontrate.

- Mirëmbajtje të pajisjeve/sistemeve për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1 Supozimet

- Kontrata do të përfundojë me sukses brenda afateve të përcaktuara në dokumentacionin për këtë procedure.
- Autoriteti kontraktor do të vërë në dispozicion të operatorit ekonomik të gjitha informacionet lidhur me konfigurimet në pajisjet ekzistuese dhe materialet e nevojshme për implementimin e projektit.
- Informacioni i shkëmbyer mes palëve duhet të mbetet konfidencial.
- Staf i operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të punojë në një ambient me disiplinë të ndryshme pune.
- Stafet përkatës të Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik duhet të jenë komunikues dhe të aftë të bashkëpunojnë.

3.2 Risqet

- Nivel i ulët bashkëpunimi mes stafit të Autoritetit Kontraktor dhe atij të Operatorit Ekonomik.
- Eksperienca e stafeve që do të përfshihen në realizimin e projektit.
- Mungesa e përshtatmërisë së sistemit të ri me kërkesat dhe pritshmëritë e Autoritetit Kontraktor.
- Mosrespektim i afateve të përcaktuara.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqëverisjen vendore” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- 4.Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Detyrat kryesore që lindin nga zbatimi i kësaj kontrate përfshijnë (por nuk kufizohen në):

- Sigurimi/implementimi i sistemeve/pajisjeve, objekt kontrate që përmbush të gjitha kërkesat funksionale dhe teknike të paraqitura në këtë dokument.
- Mirëmbajtje e sistemit në të gjithë komponentët e tij përbërës për një periudhë kohore prej 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim.

4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Bashkia Tiranë

4.2 Detyrat specifike

Faza I –Faza përgatitore/analiza e kërkesave.

Gjatë kësaj faze do të realizohen:

- Ngritja dhe konfirmimi i grupeve të punës që do të jenë përgjegjës për zbatimin e kontratës.
- Planifikimi i burimeve njërëzore dhe materialeve të nevojshme për realizimin e kontratës nga secila palë.
- Përcaktimi i hapave të realizimit të projektit dhe afatet konkrete kohore.
- Inspektim në vend për shqyrtimin e ambjentit fizik të instalimit
- Dokumentim i kërkesave teknike dhe administrative nga ana e Operatorit në lidhje me ato që duhet të plotësojë Autoriteti Kontraktor për realizimin me sukses të projektit.
- Referime në kuadrin ligjor.
- Vlerësimi i mundësive të ndryshme për përshtatjen e sistemit.
- Përgatitja nga ana e Bashkisë e ambjenteve fizike për instalimin e sistemeve të parashikuara.

Gjatë kësaj faze, Operatori Ekonomik duhet të këtë të qartë çfarë aktiviteteve specifike teknike do kryejë në fazat e tjera dhe do të përgatisë planin e qartë të punës.

Në përfundim të kësaj faze do të përgatiten ambjentet e instalimeve, objekt kontrate.

Faza II – Instalimi/ konfigurimi i sistemit të sallës së këshillit dhe testimi

Në këtë faze do të realizohet furnizimi i pajisjeve të parashikuara sipas kontratës, instalimi fizik i çdo pajisje dhe konfigurimet përkatëse.

- Instalimi fizik dhe konfigurimi i pajisjeve të reja
- Instalim dhe konfigurime të Software administrimi dhe votimi
- Testimi funksional dhe dokumentimi.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe instalojë të gjitha pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për funksionimin e plotë të sistemit, duke përfshirë kabllimet, konfigurimet, konektorët, elementët e montimit, integrimin me infrastrukturën teknike ekzistuese dhe çdo komponent tjetër ndihmës.

Qëllimi i aktiviteteve të kësaj faze përfshin gjithashtu testimin e të gjithë sistemit të sallës së këshillit bashkiak të instaluar.

Operatori duhet të kryejë dhe testim funksional dhe akustik për të verifikuar funksionimin korrekt të sistemit audio dhe video.

Aktivitetet e kësaj faze do duhet të kryhen gjatë fundjavës dhe pas orarit zyrtar, që të mos ndikohet shërbimi në Institucion.

Faza III –Trajnimi i përdoruesve

- Organizim i trajnimeve për përdoruesit fundorë dhe administratorët teknikë të sistemit.
- Dorëzimi i manualeve të përdorimit.

Faza IV- Marrja në dorëzim

Pasi të gjithë proceset dhe funksionalitetet të jenë testuar dhe provuar dhe pasi të jetë realizuar dhe trajnimi i stafit, do të bëhet dorëzimi final i sistemit të sallës së këshillit bashkiak. Në dorëzimin final do të përfshihen të gjithë komponentët si dhe dokumentimi i të gjitha konfigurimeve përkatëse.

Sistemi i sallës së këshillit bashkiak do të konsiderohet i pranuar vetëm pas testimit dhe verifikimit të plotë të të gjitha funksionaliteteve të kërkuara sipas këtij dokumenti.

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin teknik të sistemit, duke përfshirë manualët e pajisjeve, skemën e instalimit, konfigurimin e sistemit dhe udhëzimet për përdorimin dhe administrimin e tij.

Në përfundim të kësaj faze Operatori duhet të dorëzojë:

- Raport final i implementimit,
- Dëshmi të mbulimit të garancisë së kërkuar

Faza V – Mirëmbajtje e sistemit

Qëllimi i kësaj faze është mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve, objekt kontrate, në gjendje funksionale dhe teknike të plotë, përmes aktiviteteve të mirëmbajtjes.

Gjatë shërbimit të mirëmbajtjes, kontraktori duhet të kryejë azhurnime të sistemit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor kur ka ndryshime ligjore dhe proceduriale që hyjnë në fuqi, por jo vetëm.

Mirëmbajtja do të realizohet për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes në dorëzim të projektit.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Bashkia Tiranë, Godina Qëndrore.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 2 (dy) muaj nisur nga kjo datë për realizimin e projektit me të gjithë komponentët përbërës.

Periudha e mirëmbajtjes do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes në dorëzim.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në origjinal dhe 2 kopje:

1. Raporti Fillestar prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas 2 javësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktori duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura. Kontraktori duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar.
2. Drafti i raportit përfundimtar i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 2 javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
3. Raporti final me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një

përshkrim mjaftueshëm të detajuar Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor.

Raportet e përmendura më sipër duhet t'i dorëzohen komisionit të përcaktuar nga AK për ndjekjen e kontratës. Ky komision do të jetë përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. GARANCIA

Pajisjet duhet të jenë të mbuluara me garanci deri në përfundim të kontratës.

Shërbimet e garancisë do të funksionojnë si më poshtë:

- Garancia përfshin çdo komponent hardware apo software të furnizuar.
- Shërbimi i garancisë nënkupton riparimin apo zëvendësimin e çdo pjese apo komponenti hardware apo software të furnizuar, që paraqet difekt apo anomali në funksionimin e tij përkundrejt pritshmërisë se parashikuar dhe të pranuar nga palët.
- Riparimi apo zëvendësimi i pjesëve me difekt kryhet nga Operatori Ekonomik, pa kosto shtesë, pas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.
- Koha e kryerjes së shërbimeve të garancisë do t'u përshtatet termave të mirëmbajtjes të parashikuara, varësisht kriticitetit dhe prioritetit të difektit.
- Garancia nuk parashikon riparime apo zëvendësime të pjesëve që rezultojnë të difektuara nga keqpërdorimi, mosplotësimi i kushteve teknike të parashikuara për funksionimin normal që do të paraqiten në skedat teknike të produkteve, përfshirë këtu anomali në furnizimin me energji, goditje rrufeje, goditje mekanike, ndërhyrje të paautorizuara në sistemet operative të pajisjeve apo shkaqë të tjera që janë jashtë kontrollit të Operatorit Ekonomik.

8. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes do të jetë për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e dorëzimit përfundimtar.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

Shërbimet e mirëmbajtjes do të përfshijnë shërbimet e suportit software të prodhuesit për gjithë periudhën e mirëmbajtjes.

Përgjatë gjithë periudhës së parashikuar të suportit të prodhuesit do të jetë e mundur:

- përfshiri i shërbimit të mirëmbajtjes software të sistemeve, përfshirë aksesin në çdo update dhe upgrade software të sistemit në terësi apo komponentëve të vecantë.
- Mbështetje nga prodhuesi për çfarëdo çështje teknike apo administrative të lidhur me sistemin dhe komponentët e tij.
- Akses në dokumentacionin teknik dhe resurset e tjera teknike të lidhur me produktet
- Mundësia për të përfshirë shërbime të tjera profesionale nga prodhuesi, të paraparashikuara në këtë kontratë, me kostot relative për çdo shërbim.
- Komunikimi me prodhuesin do të bëhet 24x7, përmes portalit të suportit të prodhuesit, online, me telefon, ose electronic mail, nga vetë Operatori Ekonomik, duke mbajtur te azhurnuar Institucionin.

Përgjatë periudhës së mirëmbajtjes, Operatori Ekonomik do të kryejë specififikisht këto shërbime (por nuk kufizohen në):

- Operatori ekonomik duhet të kryejë kontrole periodike për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit.

Kjo përfshin:

kontrollin e funksionimit të mikrofonëve dhe njësive delegate

kontrollin e kamerave PTZ dhe preset-eve

kontrollin e sistemit audio (DSP, amplifikatorë, altoparlantë)

verifikimin e kabllimeve dhe lidhjeve

kontrollin e njësisë së regjistrimit dhe hapësirës së ruajtjes.

- Operatori ekonomik duhet të kryejë përditësime të softuerit (Software Updates)
 - instalimin e përditësimeve të softuerit të sistemit
 - instalimin e patch-eve të sigurisë
 - përditësime të firmware për pajisjet kur janë të disponueshme nga prodhuesi.
- Backup dhe konfigurimi i sistemit
 - backup të konfigurimit të sistemit
 - backup të konfigurimit të DSP

- ruajtjen e konfigurimit të kamerave dhe sistemit të votimit.
- Kontrolle, veprime diagnostikuese që lidhen me analizën e kontrolleve dhe riparuese në rast se gjykon se ka nevojë për riparime të zërave objekt kontrate.
- Konfigurime e rikonfigurime në rast problemesh me pajisjet ose nëse kërkohet nga Autoriteti
- Përmirësime apo ndryshime në sistem (me kërkesë të Autoritetit), apo ndryshime të tilla mund të propozohen nga Operatori ekonomik dhe të aprovohen nga Autoriteti.

Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjithë komponentët e këtij projekti. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë Bashkisë Tiranë, përveç rasteve kur në kontrate përcaktohet një vendndodhje e re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Shërbime Riparimi në vendndodhje

Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë interval kohor, nga e Hëna në të Premte, 08:00-17:00, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i Autoriteti Kontraktor ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të komponentëve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të shërbimit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i Autoriteti Kontraktor dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

Stafi përgjegjes do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje Web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të

kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë Autoritetin Kontraktor dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, personeli i autorizuar do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar.

Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi brenda intervalit kohor prej 1 (një) ore nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa:

- (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”;
- (b) Tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër;
- (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose
- (d) Operatori ekonomik arrin në konkluzionin që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Kanalet e komunikimit mes paleve

Palet komunikojnë në lidhje me njoftimet teknike përmes këtyre kanaleve të komunikimit:

- E-mail
- Telefon fiks mobile
- Chat/audioo/video call të shërbyer përmes vetë sistemit të ri të komunikimit të

unifikuar. Autoriteti Kontraktor do të krijojë dhe menaxhojë grupet e komunikimit, duke përfshirë këtu edhe skuadren e suportit teknik të Operatorit.

Termat e Mirëmbajtjes:

- Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të vazhdueshme (Marrëveshjen SLA) për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i komponentëve të kontratës rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i komponentëve të kontratës krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i komponentëve të kontratës pengon në mënyrë minimale aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i komponentëve të kontratës ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i komponentëve të kontratës ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i komponentëve të kontratës ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i komponentëve të kontratës pengon realizimin e aktiviteteve në sallën e këshillit.	Mos funksionimi i komponentëve të kontratës con në shtyrjen e fillimit të aktiviteteve në sallën e këshillit.	Mos funksionimi i komponentëve të kontratës pengon disa pjesë të vogla të realizimit të aktiviteteve.
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<u>Nuk ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
○ 30 min. për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 1 ore nga momenti i marrjes së njoftimit.	○ 30 min.për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 2 orëve	○ 60 min.për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 4 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Shuma Totale (Lekë pa TVSH)	Afati
1.	F.V Njësi qendrore për sistem diskutimi	copë	1			
2.	F.V Njësitë delegate/chairman me ekran	copë	63			
3.	Lexues/shkrues kartash	copë	1			
4.	Kartë elektronike identifikimi	copë	63			
5.	Softuer administrimi dhe votimi	copë	1			
6.	F.V Njësi regjistrimi	copë	1			
7.	F.V Kamera PTZ	copë	4			
8.	F.V Altoparlant kolonë	copë	6			
9.	F.V Amplifikator fuqie	copë	3			
10.	F.V Matriks audio	copë	1			
11.	F.V Mikser audio	copë	1			
12.	F.V Njësi sekuencimi	copë	1			
13.	Monitor 75'	copë	1			
14.	Trajnimi i përdoruesve	ditë	5			
15.	Shërbimi i mirëmbajtjes	muaj	12			
TOTALI PA TVSH (LEKË)						

10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTI

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3-M14
1	Faza I –Faza përgatitore/analiza e kërkesave.	<i>x</i>		
2	Faza II – Instalimi/konfigurimi i sistemit të sallës së këshillit dhe testimi	<i>x</i>	<i>x</i>	
3	Faza III –Trajnimi i përdoruesve		<i>x</i>	
4	Faza IV- Marrja në dorëzim		<i>x</i>	
5	Faza V – Mirëmbajtje e sistemit			<i>x</i>

11. SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Njësi qendrore për sistem diskutimi

Ndërtimi dhe instalimi fizik	Procesor digjital rack 19” Lartësi $\leq 1U$ Mbështetje ≥ 32 mikrofone aktivë Sistemi duhet të mbështesë të paktën 63 njësi delegate/chairman. Numri i mikrofonëve aktivë njëkohësisht duhet të jetë i konfigurueshëm përmes softuerit të sistemit.
Arkitektura e komunikimit	Rrjet komunikimi nëpërmjet kabllave CAT5e ose CAT6, që ofron: • Sinjal audio digjital me cilësi të lartë; • Komunikim kontrolli për menaxhimin e mikrofonëve; • Aftësi lidhje “daisy-chain” ose “loop redundancy”; • Lidhje e thjeshtë dhe efikase për instalime të gjata deri në dhjetëra metra pa degradim sinjali.

Hyrje/Dalje Audio	• Të paktën 2 hyrje audio për integrim me pajisje të jashtme (mikserë, lavalier, laptop, pajisje streaming). • Të paktën 8 dalje audio të konfigurueshme për: salla ndihmëse, sisteme të jashtme të përforcimit (amplifier), regjistrim, votim ose interpretim simultan (si kanale të ndara). Kontroll i nivelit, matricë ruterimi dhe konfigurim fleksibël brenda DSP-së.
DSP i integruar (Digital Signal Processor)	Pajisja duhet të përmbajë një DSP të avancuar profesional me funksione të integruara: • AGC – Automatic Gain Control: e cila balancon automatikisht volumin e folësit; • AEC – Acoustic Echo Cancellation: eliminon jehonën • ANC – Active Noise Cancellation: ul zhurmat e ambientit (fryma, trafik, ventilim); • AFC – Automatic Feedback Cancellation: mbron nga fishkëllimat (feedback akustik) kur përdoren altoparlantë në të njëjtën hapësirë.
Kontroll kamerash PTZ	• Integrim automatik me kamera të lëvizshme PTZ për fokusim të kamerës sipas folësit. • Protokolle të mbështetura (ose ekuivalente): • VISCA • Pelco-D, • Pelco-P. • Aktivizim automatik i preset-it të kamerës bazuar në mikrofonin që aktivizohet.
Përputhshmëria me Standardet & Funksione Shtesë të Kërkuara	Pajisja duhet të jetë në përputhje me standardin ndërkombëtar IEC 60914 (ose ekuivalente), që rregullon: • Sigurinë elektrike, • Performancën audio, • Funksionalitetin dhe ndërveprimin e sistemeve të diskutimit. Mundësi regjistrimi audio (lokal ose përmes softuerit). • Konfigurim përmes ndërfaqes web

	(browser-based). • Mbështetje për integrim në sisteme kontrolli: AMX, Crestron ose të ngjashme. • Opsionalisht: mbështetje për votim elektronik ose interpretim simultan.
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

2. NJËSITË DELEGATE/CHAIRMAN ME EKRAN

Ndërtimi dhe tipologjia	Njësitë delegate/chairman duhet të jenë pajisje profesionale për sisteme diskutimi, të pajisura me ekran touch, mikrofon kondensator dhe funksione të avancuara menaxhimi. Çdo njësi duhet të konfigurohet si delegate ose chairman përmes softuerit të sistemit. Njësitë chairman duhet të kenë opsione shtesë të kontrollit (si prioritet, mute, menaxhim folësish).
Ekrani	Çdo njësi duhet të përfshijë ekran touchscreen me madhësi jo më pak se ≥ 4.2 ”, i cili të ofrojë: • Navigim të menisë, • Shfaqje statusi folësi, • Rezultate votimi, • Identifikim delegate, • Opsione të kontrollit dhe ndërveprimit. Ekrani duhet të jetë rezistiv ose kapacitiv

Funksionalitetet e integruara	Njësitë duhet të mbështesin: Identifikim • NFC/IC Card Reader të integruar për identifikim të delegatëve. • Përputhshmëri me kartela standarde identifikimi (p.sh. RFID, NFC, IC card). Votim Elektronik Të ofrojë minimalisht funksione votimi: • Pro, • Kundër, • Abstenim, • Zgjedhje me shumë opsione (multi-choice), • Regjistrim automatik të rezultatit. Funksione të diskutimit • Kërkesë fjale (request-to-speak). • Menaxhim rradhe (queue management). • Shfaqje e statusit të mikrofonit në ekran. • Funksione për chairman: priority override, mute all, approve request.
Audio dhe gjenerimi i zërit	Çdo njësi duhet të ketë altoparlant të integruar me cilësi të lartë dhe nivel të kontrollueshëm të volumit. Duhet të përfshijë dalje kufjesh 3.5 mm për dëgjim individual. Trajtimi i zërit duhet të jetë plotësisht digjital përmes sistemit qendror.
Mikrofoni	Çdo njësi duhet të përmbajë mikrofoni gooseneck profesional me: • Lartësi ≥ 400 mm, • Teknologji kondensator, • Polaritet kardiod (directional) për reduktim zhurmash dhe përqendrim te folësi. Mikrofoni duhet të jetë i shkëputshëm dhe i zëvendësueshëm. Duhet të ketë dritë LED indikatore të aktivizimit.
Ndërfaqja, lidhja dhe përputhshmëria	-Lidhja me procesorin duhet të bëhet përmes kabllove CAT5e/CAT6.

	-Njësitë duhet të marrin audio, kontroll dhe energji përmes të njëjtit kabllim (PoE ose protokoll vendor). -Pajisjet duhet të jenë plotësisht të integrueshme me procesorin qendror të sistemit të ofertuar nga operatori ekonomik. -Njësitë duhet të jenë në përputhje të plotë me standardin IEC 60914 ose ekuivalente .
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

3. LEXUES/ SHKRUES KARTASH

Për të bërë të mundur programimin/rregjistrimin e kartave të identifikimit të këshilltarëve nëpërmjet kësaj kontratë kërkohet pajisje lexues/ shkrues kartash.

- Shkruese për kartë IC pa kontakt (RFID), i përdorur si aksesori për sistemet e konferencave (për “sign-in” dhe identifikim).
- Lidhja me USB
- Standardet ISO/IEC 14443-A / MIFARE ose ekuivalente.

4. KARTË ELEKTRONIKE IDENTIFIKIMI

Teknologjia e komunikimit	Kartë kontaktless që punon në frekuencën 13.56 MHz (RFID / NFC) ose ekuivalente.
Kapaciteti i memories	Kartë me memorie minimale ≥ 1 KB për ruajtjen e të dhënave të identifikimit.

5. SOFTWARE ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

Software për administrimin, konfigurimin dhe menaxhimin e sistemit të diskutimit dhe votimit elektronik, i cili mundëson identifikimin e delegatëve, menaxhimin e mikrofonëve, realizimin e votimit elektronik dhe gjenerimin e rezultateve të votimit .

Software duhet të mundësojë:

- Software duhet të mbështesë të paktën 63 përdorues (delegate)/chairman.
- Software duhet të mundësojë identifikimin e delegatëve, menaxhimin e mikrofonëve, realizimin e votimit elektronik dhe gjenerimin e rezultateve të votimit.
- Licenca e software duhet të jetë e përhershme dhe pa kufizim në kohë për përdorim nga autoriteti kontraktor.

- Software duhet të ofrojë ndërfaqe grafike për administrimin e sistemit dhe të jetë i aksesueshëm përmes pc (pajisje fundore) ose përmes ndërfaqes web.
- Software duhet të mundësojë shfaqjen e rezultateve dhe eksportimin e rezultateve të votimit në formate standarde (PDF, Excel ose ekuivalente).

Sistemi i administrimit dhe votimit duhet të mbulojë të gjitha vendet e delegatëve dhe të integrohet me sistemin audio-video të sallës.

6. NJËSI REGJISTRIMI

Përshkrimi	Kamerat PTZ dhe njësia e regjistrimit duhet të sigurojnë kapje video me cilësi të lartë, kontroll të avancuar, integrim me sistemin e diskutimit dhe mundësi auto-tracking të kamerës bazuar në mikrofonin aktiv. Sistemi duhet të ofrojë regjistrim të shumë kanaleve në kohë reale, si dhe streaming live.
Njësia e Regjistrimit (NVR / Recorder Profesional Video)	Hyrjet dhe kapacitet • Duhet të ketë ≥ 4 hyrje HDMI me mundësi regjistrimi të sinjaleve të shumëfishta në kohë reale. • Duhet të përfshijë HDD minimal 1TB të integruar për ruajtjen e materialit video. Streaming dhe Output • Duhet të mbështesë transmetim live përmes rrjetit (RTMP / RTSP / HTTP). • Duhet të ketë dalje video HDMI për monitorim të drejtpërdrejtë. • Menaxhim i skedarëve, kohëzgjatjes dhe ndarjeve të regjistrimeve. Menaxhimi i Sistemit • Mundësi për të regjistruar çdo kamerë individualisht ose kombinime të tyre. • Ruajtje dhe eksport i materialeve në formate të zakonshme video (MP4, MOV, etj.).
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

7. KAMERA PTZ

Përshkrimi	Kamerat PTZ dhe njësia e regjistrimit duhet të sigurojnë kapje video me cilësi të lartë, kontroll të avancuar, integrim me sistemin e diskutimit dhe mundësi auto-tracking të kamerës bazuar në mikrofonin aktiv. Sistemi duhet të ofrojë regjistrim të shumë kanaleve në kohë reale, si dhe streaming live.
Kamera PTZ	• Kamera duhet të ketë zoom optik $\geq 20x$. • Duhet të përfshijë sensor me ndjeshmëri të lartë për ambient me ndriçim të ulët. • Shpejtësi dhe saktësi të lartë të lëvizjes pan/tilt. Kamera duhet të ketë minimalisht këto dalje të integruara: • HDMI • USB 3.0 • SDI (3G-SDI ose më lartë) • LAN (IP Streaming) Duhet të mbështesë transmetim në protokolle të zakonshme si RTSP, RTMP, NDI HX (opsionale sipas modelit). Kamera duhet të mbështesë kontroll përmes protokolleve(ose ekuivalente): ○ VISCA (RS-232 / RS-422 ose IP) ○ Pelco-D ○ Pelco-P ○ Duhet të jetë e integrueshme me procesorin e diskutimit për auto-tracking sipas mikrofonit aktiv. Duhet të mbështesë auto-tracking të automatizuar, ku kamera fokusohet te folësi bazuar në: ○ Mikrofonin aktiv të sistemit të diskutimit, ○ Preset-et e kamerës të lidhura me secilën njësi mikrofonike. ○ Reagim i menjëhershëm dhe i qëndrueshëm i lëvizjes së kamerës.
Periudha e Mbulimit të Garancisë	1 vit

“Warranty”:	
-------------	--

8. ALTOPARLANT/AMPLIFIKATOR FUQIE/MATRIKS AUDIO/ MIKSER AUDIO/NJËSI SEKUENCIMI

Përshkrimi	Sistemi i zërit duhet të sigurojë shpërndarje uniforme të audio-s me cilësi profesionale në sallë konferencash dhe ambientet e mbledhjeve. Pajisjet përfshijnë altoparlantë, amplifikatorë, DSP audio, mikser dhe njësitë e menaxhimit të fuqisë, të përshtatura për përdorim 24/7 me performancë të qëndrueshme dhe siguri elektrike.
Pajisjet	Altoparlantët (altoparlantë kolonë) • Fuqia: $\geq 120\text{W AES}$ secili. • Ndjeshmëria: $\geq 90\text{ dB}$. • Tipologjia: Kolonë profesionale për shpërndarje homogjene të zërit. • Materiali: Konstruksion i fortë, i përshtatshëm për instalim të përhershëm në tavan ose mure. • Frekuencat: Mbështetje minimale $80\text{ Hz} - 18\text{ kHz}$. Amplifikatorët Kapaciteti: • Të paktën 3 amplifikatorë $200\text{W} \times 2 @ 8\Omega$ ose • Të paktën 3 amplifikatorë $300\text{W} \times 2 @ 4\Omega$ Funksione: • Mbrojtje nga mbingarkesat, termike dhe shortcircuit. • Kompatibilitet me altoparlantët e specifikuar. • Funksionim i qëndrueshëm për orë të gjata. DSP Audio Pajisja DSP duhet të përmbajë: • Matricë 8×8 audio (8 hyrje, 8 dalje). • Funksione të integruara: ○ AEC – Acoustic Echo Cancellation ○ ANC – Active Noise Cancellation ○ AFC – Automatic Feedback Cancellation

	• Përpunim 24-bit / 48kHz për cilësi profesionale audio. DSP duhet të ofrojë: • EQ për secilin kanal, • Limiter dhe Compressor, • Delay të personalizueshëm, • Routing fleksibël midis burimeve dhe daljeve. Mikseri Audio Numri minimal i hyrjeve: Të paktën 8 kanale audio. Mbështetje për burime të ndryshme: mikrofonë, laptop, pajisje streaming. Funksione: • Kontroll niveli, • Mute individuale, • Grupim kanalesh dhe routing në dalje të zgjedhura. Integrim i plotë me DSP për përpunim të avancuar të zërit. Njësia e Sekuencimit të Fuqisë Funksion: ndezje/fikje të sinkronizuar të amplifikatorëve dhe altoparlantëve për: • Mbrojtje të pajisjeve nga rritje tensioni, • Sinkronizim të sigurt të sistemit audio gjatë aktivizimit. Ndërtim industrial, i përshtatshëm për rack 19”.
Integrimi dhe funksionimi	Sistemi duhet të jetë i përputhshëm me procesorin qendror dhe njësitë e diskutimit. Menaxhim dhe konfigurim përmes softuerit të sistemit DSP. Funksionim 24/7 me performancë të qëndrueshme dhe mbrojtje nga mbingarkesat.
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

Operatori ekonomik duhet të analizojë akustikën e ambientit dhe të propozojë konfigurimin optimal të sistemit audio për të siguruar shpërndarje uniforme të zërit në sallë.

Operatori ekonomik duhet të kryejë konfigurimin dhe kalibrimin e plotë të sistemit audio dhe procesorit DSP pas instalimit të pajisjeve, në mënyrë që të sigurohet shpërndarje uniforme e zërit dhe cilësi optimale audio në të gjithë sallën e këshillit.

9. MONITOR 75'

Madhësia e ekranit	≥ 75''
Procesor	ARM Cortex-A55 ose ekuivalent
Rezolucioni	4K Ultra hd, 3840 x 2160 pixel
Raporti kontrastit Statik	1,200:1
Shkëlqimi	Min.450 cd/m2
Koha e reagimit	8ms
Këndet e shikimit	178 ⁰ horizontale 178 ⁰ vertikale
LAN	10/100/1000 Mbps
Display number of colours	≥ 1.07 billion colours
Kapaciteti RAM	Min. 32 GB
Lidhjet	Min. HDMI 2.0 In (3), HDMI Out (1), VGA (1), Composite RCA (1), 3.5mm Audio In (1), 3.5mm Audio Out (1), SPDIF Audio Out(1), USB 3.0 (2), USB 2.0 (4), Slot-in PC Slot(1), USB B Touch Port(2) RS232(1), Ethernet LAN (RJ45)(1), WIFI
Sistem Operimi	Android 11 ose me lart
Ora e Operimit (hours/days)	24/7
Temperatura Operimit	0-40°C


Të përfshihet suporti për montimin në mur	PO
Garancia	1 vit

10. Planimetria orientuese e Sallës së Këshillit Bashkiak

Ky aneks paraqet planimetrinë orientuese të Sallës së Këshillit Bashkiak, me qëllim informimin e operatorëve ekonomikë mbi organizimin fizik të ambientit ku do të implementohet sistemi i diskutimit, votimit elektronik, audio dhe video.


Planimetria shërben vetëm si referencë për hartimin e zgjidhjes teknike dhe nuk përbën projekt ekzekutiv apo specifikim të detyrueshëm për mënyrën e implementimit të pajisjeve.

Operatorët ekonomikë duhet të marrin në konsideratë organizimin fizik të sallës, dimensionet orientuese të saj, pozicionimin e tavolinës së kryesisë, sektorët e këshilltarëve, korridoret e aksesit dhe elementët konstruktivë të ambientit gjatë hartimit të zgjidhjes teknike dhe projektimit të sistemit.



Shënim: Operatori ekonomik, gjatë implementimit të projektit, do të shfrytëzojë infrastrukturën ekzistuese të Autoritetit Kontraktor (kanalet teknike, rrjetin e kabllimit, pikat e energjisë elektrike, rack-et ekzistuese, elementët e montimit dhe infrastrukturën tjetër pasive), në rastet kur kjo është teknikisht e përshtatshme, funksionale dhe nuk cenon cilësinë, sigurinë apo funksionimin e sistemit të propozuar. Në rast se infrastruktura ekzistuese nuk është e

përshtatshme ose nuk garanton funksionimin optimal të sistemit, operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe instalojë të gjithë komponentët shtesë të nevojshëm, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor. Çdo infrastrukturë ekzistuese që do të ripërdoret duhet të verifikohet paraprakisht nga operatori ekonomik dhe të jetë në përputhje me kërkesat teknike të sistemit të ofruar.



Punoi grupi i punes miratuar me urdhër titullari Nr. 1905, datë 17.10.2025, me nr. 36152 prot., datë 17.10.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës, specifikimeve teknike dhe përcaktimin e vlerës limit të kontratës konform legjislacionit në fuqi për realizimin e procedurës me objekt “Sistemi Multifunksional për Sallën e Këshillit Bashkiak”: